



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Datë: 08.08.2023

Ref. KM-278/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

VENDIM

Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim

1. Lejohet importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve – Glifocyd 360 SL i prodhuesit “Ciech Sarzyna S.A”, Poloni nga përfaqësuesi i saj “Agrounion” SH.P.K, Fushë Kosovë.

2. LLOJI I PRODUKTIT: Herbicid

3. PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE: Glyphosate.....360g/kg

4. PËRDORIMI:

Glifocyd 360 SL është herbicid jo selektiv me veprim sistemik, aplikohet me sistem foliar në formë të koncentruar me përgatitjen e tretësirës ujore. Përthithet përmes pjesëve të gjelbra të bimëve(gjethet, lastarët e gjelbër dhe lëvorja e pa linjifikuar) dhe më pas shpërndahet në të gjithë bimën dhe arrin në pjesët e saj nëntokësore (rrënjët, rizomat etje) duke shkaktuar vdekjen e tyre. Simptomat e para të veprimit të produktit (zverdhja dhe vyshkja) janë të dukshme 7-10 ditë pas trajtimit. Bimët vdesin plotësisht pas 2-3 javësh. Temperatura e lartë dhe lagështia e ajrit si dhe rrezet e forta të diellit përshpejtojnë veprimin e produktit. Kontrollon barërat e këqija gjethengushta dhe gjethegjera një dhe shumëvjeçare. Përdorimi: 3-10L/ha, me trajtim foliar gjatë rritjes intensive të barërave të këqija. Sasia e ujit: 200-400L/ha.

5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:
250ml, 1L, 20L, 200L, 500L, 1000L.

6. VËREJTJE:

Përdoreni këtë produkt në atë mënyrë që është në përputhje me masat higjienikë dhe teknike të mbrojtjes. Mos lejoni të bie në kontakt me lëkuren dhe mukozën. Rekomandohet të vishni veshje mbrojtëse, dorëza dhe syze për mbrojtjen e syve/fytyrës. Gjatë punës mos hani apo pini duhan. Pas punës lani me ujë dhe sapun duart, fytyrën dhe nëse është e nevojshme edhe pjesët e tjera të trupit. Gjatë trajtimit parandaloni kontaminimin e ujit (rrjedha ujore, puse, liqene, burime uji, kanalizime) duke trajtuar të paktën 20m larg tyre. Nëse produkti hyn në kanale kanalizimesh ose në rrjedha ujore, informoni autoritetet përkatëse.

7. KARENCA:

Nuk ka.



GHS07- ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)

8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:

9. VENDI I SHITJËS: Në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

10. Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar në Databazën e Pesticideve të BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit të produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivit.